



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.187/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli ne Prishtinë, kundër debitorit “Vëllezërit Kryeziu” shpk, me NUI70390159 me seli ne Gjakovë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti Ekonomik KPPP.nr.1098/23 të datës 29.11.2023, me datën 07.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitori “Vëllezërit Kryeziu” shpk, me NUI70390159 me seli ne Gjakovë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti Ekonomik KPPP.nr.1098/23 të datës 29.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti Ekonomik, me aktvendimin KPPP.nr.1098/23 të datës 29.11.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Vëllezërit Kryeziu” shpk me seli ne Gjakovë, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.342/23 të datës 16.06.2023, i lëshuar nga zyra e Përmbaruesit Privat Gjokë Radi, për territorin e Gjykatës Themelore ne Gjakovë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar dhe aktvendimin e atakuar ta anuloj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 16.06.2023, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbarimor aktvendimit, te Komisioni te Pavarur për Miniera dhe Minerale nr.1749 te datës 23.05.2022, i cili ka marre forme të prerë me

date 08.07.2022 dhe është bere i ekzekutueshëm me date 24.07.022 me te cilin debitori është detyruar qe kreditorit ne emër te gjobës te i paguaje shumen prej 6,336.89 euro.

Përmbaruesi private Gjokë Radi, për territorin e Gjykatës Themelore ne Gjakovë, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.342/23 të datës 16.06.2023, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që në emër te gjobës, te i paguaje ne xhirrollogarinë e Buxhetit te Kosovës shumën ne total prej 6,336.89 euro, si dhe pagesën e shpenzimeve tjera përmbarimore deri ne pagesën definitive.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 04.07.2023, duke theksuar aktvendimi si dokument përmbarimore është marre ne kundërshtim me gjendjen faktike, ka qene i panevojshëm, i gabuar dhe se nuk përkon me gjendjen faktike. andaj propozon qe gjykata, këtë urdhër përmbarimor ta anuloj

Ndaj prapësimin te debitorit, kreditori ka parashtruar përgjigje ne prapësim me dt.10.07.2023, duke arsyetuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit, se vendimi qe përbën dokument ekzekutiv është i ligjshëm dhe se drejte është konstatuar gjendja faktike andaj propozon e gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin për lejimin e përmbarimit ta vërtetoj

Gjykata Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti Ekonomik, me aktvendimin KPPP.nr.1098/23 të datës 29.11.2023, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar së pretendimet e debitorit janë te pabazuara pasi bazuar ne shkresat e lëndës shihet se propozimi për përmbarim është ne pajtim me nenin 69 dhe 71 si dhe ne pajtim me nenin 21 dhe 22, te LPP, se debitori ka qenë i obliguar ti paguaj prestimin ne përputhje me titullin ekzekutiv.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit përmbarimor aktvendimit, te Komisioni te Pavarur për Miniera dhe Minerale nr.1749 te datës 23.05.2022, i cili ka marre forme të prerë me date 08.07.2022 dhe është bere i ekzekutueshëm me date 24.07.022 me te cilin debitori është detyruar qe kreditorit ne emër te gjobës te i paguaje shumen prej 6,336.89 euro, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 dhe 22 të njëjtit ligj.

Në rastin konkret Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkalles se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe se e as ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë

te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.187/24, me datë 07.06.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami